



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 13 Prot

Tiranë, më 13.04 2014

**VENDIM Nr. 300, dt. 18.04.2014**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 18.04.2014, mbasi shqyrtoi "Raportin e sondazheve arkeologjike për Projektin: "**Rehabilitimi dhe rivitalizimi i Shëtitores Republika dhe Sheshit Teodor Muzaka**", **Parku Perëndimor dhe Parku Lindor, Berat** - Subjekti "Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim" (AADF),

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë "Raportin e sondazheve arkeologjike" përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Berat, për Projektin: "**Rehabilitimi dhe rivitalizimi i Shëtitores Republika dhe Sheshit Teodor Muzaka**", **Parku Perëndimor dhe Parku Lindor, Berat** - Subjekti "Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim" (AADF).
- II. Përpara fillimit të zbatimit të Loteve të tjera të projektit të nënshkruhet kontrata dypalëshe midis Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe "Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, ku të përcaktohen në mënyrë të detajuar detyrimet e palëve.
- III. Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikëqyrja arkeologjike periodike e punimeve nga specialistë arkeologë të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Berat dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- IV. Të krijohet mundësia e ekspozimit *in situ*, të vazhdimit të kolektorit në lotet e tjera të projektit.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**

**SEKRETARI I KKA**  
**ARTAN PUTO**



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, Nr. 76, ish Kinostudio  
Tiranë, Shqipëri,  
Tel/Fax: 04 2272171  
[www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)